| 17.15 | <b>Film prezantues produktesh</b> – Forever Pomesteen<br><i>Fluturo si një shqiponjë!</i> |
| 17.25 | <b>Michael Strachowitz</b> – Si ta fillosh...?  |
| 17.40 | <b>Nga bima deri tek produkti</b>   |
| 18.00 | <b>Lajme</b>  |
| 18.05 | <b>FLP-ja prej 25 vitesh</b><br><i>Fluturo si një shqiponjë!</i>                          |
| 18.20 | <b>Takim managerësh 2006</b> – Szirak   |
| 18.45 | <b>Rally European 2006</b> – Kanë, Niza   |
| 19.50 | <b>Success nap</b> – Dr. Adolf L. Kosa  |
| 20.10 | <b>Film prezantues produktesh</b> – Probiotic<br><i>Fluturo si një shqiponjë!</i>         |
| 20.15 | <b>Holiday Rally – Porec – 2006.</b>  |
| 20.35 | <b>Success nap</b> – Ibolya Csaszar   |
| 20.55 | <b>E di se përse të paguajnë?</b> – Krisztina Kovacs Jungne                               |
| 21.50 | <b>FLP – Plani Marketing</b>  |
| 22.10 | <b>Success nap</b> – Tibor Radoczki   |
| 22.45 | <b>Profit Sharing 2006</b><br><i>Fluturo si një shqiponjë!</i>                            |
| 00.10 | <b>Conquistador Club</b>  |
| 01.15 | <b>Film prezantues produktesh</b> – Forever Pomesteen<br><i>Fluturo si një shqiponjë!</i> |
| 01.25 | <b>Michael Strachowitz</b> – Si ta fillosh...?  |
| 01.40 | <b>Nga bima deri tek produkti</b>   |
| 02.00 | <b>Lajme</b>  |
| 02.05 | <b>FLP-ja prej 25 vitesh</b><br><i>Fluturo si një shqiponjë!</i>                          |
| 02.20 | <b>Takim managerësh 2006</b> – Szirak   |
| 02.45 | <b>Rally European 2006</b> – Kanë, Niza   |
| 03.50 | <b>Success nap</b> – Dr. Adolf L. Kosa  |
| 04.10 | <b>Film prezantues produktesh</b> – Probiotic<br><i>Fluturo si një shqiponjë!</i>         |
| 04.15 | <b>Holiday Rally – Porec – 2006.</b>  |
| 04.35 | <b>Success nap</b> – Ibolya Csaszar   |
| 04.55 | <b>E di se përse të paguajnë?</b> – Krisztina Kovacs Jungne                               |
| 05.50 | <b>FLP – Plani Marketing</b>  |
| 06.10 | <b>Success nap</b> – Tibor Radoczki   |
| 06.45 | <b>Profit Sharing 2006</b><br><i>Fluturo si një shqiponjë!</i>                            |
| 08.10 | <b>Conquistador Club</b>  |
| 09.15 | <b>Film prezantues produktesh</b> – Forever Pomesteen<br><i>Fluturo si një shqiponjë!</i> |
| 09.25 | <b>Michael Strachowitz</b> – Si ta fillosh...?  |
| 09.40 | <b>Nga bima deri tek produkti</b>   |





**KRISZTA KIRALY**  
senior manager

***"Suksesi është vetë rruga!"***

**Jam tepër e lumtur dhe krenare që mund t'u tregoj juve rrugën time prej një viti e gjysëm, mendimet dhe mbresat e mia të shumta që kam përjetuar këtu në FLP, në këtë kompani dhe skuadër të shkëlqyer ku punoj. Po, për një vit e gjysëm arrita nivelin e seniorit, por dëshiroj t'u bëj të ditur të gjitha shkaqet dhe faktorët që më çuan drejt këtij rezultati.**

## Mos e kufizo mendimin tënd!

Më e rëndësishmja mendoj se është skuadra që më rrethon, me të cilët punoj së bashku, të cilët më japin ndihmë dhe më tregojnë drejtimin që nga fillimi. Edhe unë – dhe besoj se edhe shumë të tjerë – nuk e kuptova që në fillim se çfarë mundësie m'u dha, që të punoja në një shoqëri kaq të madhe si Forever Living, në një kompani kaq stabile dhe të sigurt. Në fillim nuk e kuptova që produktet do të kenë efekt të mirë në shëndetin tim, të familjes dhe mjedisit tim rrethues, dhe aq më tepër atë që Forever-i ka planin marketing më gjenial. Kjo për mua nuk ishte menjëherë e qartë. Unë pashë vetëm se njerëzit që përpiqen të më ndihmojnë janë profesionista, shikojnë dhe ecin në një drejtim dhe mund të më tregojnë një rrugë, një alternativë e cila mund të ketë efekt pozitiv në jetën timë nëse e shfrytëzoj atë. Por atë e ndjeva që nëse nuk e shfrytëzoj këtë mundësi, ndoshta nuk do më jepet edhe një tjetër.

Asnjëherë s'kam qenë me fat, megjithatë që kur pata sukses në këtë biznes e kam dëgjuar shpeshherë fjalinë ***"E po ti kishe fat!"***

Të gjithë ne që ndërtojmë këtë biznes e dimë shumë mirë që kjo s'ka të bëjë aspak me fatin. Edhe këtu duhet punuar si kudo tjetër, por vetëm që të paguajnë ndryshe dhe nuk duhet të presësh 40 vjet.

Nuk dëshiroj të mërzit asnjërin me historinë e jetës sime, dhe as me problemet me të cilat luftova dhe luftuam me familjen time përpara se të takohesha me këtë biznes. Më beso se mund të jem dakort me të gjitha pretekstet e tua "S'kam para, të njohur, makinë, patentë dhe nuk jam i tillë". Këto janë të zakonshme dhe e beson apo jo, për mua të gjitha ishin njëmijë herë të vërteta. Jo vetëm që nuk kishim para, por edhe të ardhura mezi kishim, pasi unë isha pa punë dhe e mbushur me shpresat e një fillestari me dy diploma fillova të kërkoj punë. Duke e menduar tani në shumë raste reagimet e punëdhënësve ishin qesharake. Më e paharrueshmja ishte kur u paraqita në një bankë me emër ku me mik arrita deri tek intervista e punës. Më ofruan 90000 Ft në një punë me turne pas tre muajsh prove në një

vend pune të papërshtatshme për diplomat e mia.

Ndërkohë që kërkoja punë, në Forever ecnim përpara dhe në ditën kur u bëra assistant manager me telefonuan që për fat të keq nuk mund të më marrin në punë sepse jam e tejshkolluar. Dhe atëherë në këtë biznes bëja dy herë më shumë para me 6-10 orë punë në javë dhe nuk kisha as proror. . .

Për 3 muaj e gjysëm arritëm nivelin e managerit. Ndoshta ty të duket shumë shpejt, por ishte tepër e thjeshtë. . . Është një fjalë kryesore të cilën e theksojmë shpeshherë. . . **qëndrimi, atitudi. . .**

Nëse je në gjendje ta besosh dhe pranosh që edhe ti mund ta bësh — *më beso, nuk është e vështirë, e kanë bërë shumë njerëz* — atëherë s'do të pengojë asgjë që të kesh sukses.

Ekzistojnë parime tepër reale dhe të thjeshta të cilat i quajmë **parimet e suksesit**, dhe nëse i ndjek ato atëherë do të keni sukses. Këtë përcaktim ma bëri të qartë **Tamas Biro** të cilin e falenderoj shumë. Sekretin im në të vërtetë ishte që pranova çdo këshillë që më dhanë sponsorët tanë.

Mua nuk më nevojitej garanci më e madhe se sa të punoja me **Adam Nagy-in, Brigi-n dhe Rex Alex-in**. Nëpërmjet tyre u njoha me ndërtesues

rrjeti si **Tamas Biro dhe Adolf L.**

**Kosa.** Mësova dhe mësoj shumë prej tyre dhe i falenderoj nga zemra që më ndihmojnë dhe kujdesen për mua. Ata më treguan që ky biznes nuk bën fjalë për produktet, por për njerëzit, jetën, zhvillimin e personalitetit dhe më treguan përvojat nga të cilat mësova shumë.

Kuptova edhe që ky biznes **pa mjete** nuk funksionon. E bëra zakon dëgjimin e kasetave, leximin e rregullt — *natyrisht nuk e kam fjalën për novela detektivash* — dhe marrjen pjesë në aktivitetet që janë të domosdoshme për të ndërtuar biznesin tim. Përdorimi i këtyre mjeteve më krijoi **qëndrimin e palëkundshëm** me të cilin ndërtoj biznesin. Tani nuk dëshiroj të flas rreth qëllimeve, me siguri është e qartë për të gjithë që duhet të kesh një qëllim, një ëndërr, duhet të kesh një diçka që të shtyn përpara, për të cilën ngrihesh në mëngjes, për të cilën punon. Siç e përmenda edhe për ne s'ishte e lehtë, edhe në jetën tonë kishte pengesa dhe vështirësi, por nuk u përqëndrova tek problemet sepse do të më kishin tretur. Natyrisht edhe këtë duhet ta mësoja. . .

Unë vija nga një qytet i vogël, nga Polgardi, dhe këtë biznes deri tek niveli i managerit e ndërtoam aty. Dy herë në javë shkoja me nënën time, pasi unë nuk kisha patentë, në prezantimet e hapura në Budapest, ku çonim të interesuarit dhe në këto situata dëshira dhe qëllimet luanin rol të madh. Kisha nevojë për to pasi

të hënën në mëngjes nuk e kishim as idenë se si do ta paguanim pasdite rrugën për në Budapest. Po, edhe mua më thanë jo, edhe unë morra refuzime, por nuk merresha me to.

E kuptova që **unë jam njeriu i duhur** për këtë biznes dhe nuk më duhet të kërkoj njeriun e duhur. Nuk mund të pres që pastaj ta bëjnë ata që solla në biznes, por vendosa që ta bëj vetë dhe duke punuar me këtë qëndrim filluan të rralloheshin edhe jo-të. . .

Pashë se me çfarë qëndrimi ecnin përpara njerëzit e suksesshëm si Adam, Alex, Tamas, Adolf, apo çdo drejtues i suksesshëm, dhe këtë doja ta mësoja edhe unë. Dhe këtë mund ta arrijë kushdo. **Më mahniti mënyra se si këta njerëz ecin përpara ndërkohë që i bëjnë të suksesshëm të tjerët dhe jo i shkelin apo i mashtrojnë si në disa vende të tjera.**

Natyrisht edhe unë kisha frikë. . . mendoj se edhe ti ke. . . , edhe për mua kjo gjë ishte e re dhe e panjohur si për ty, kisha dyshime dhe paragjykime. . .

E di nga se kisha më shumë frikë? Jo nga tregu i mbushur, dhe as nga ajo që të njohurit e mi nuk janë të tillë. E di nga se kisha frikë? **Nga disfata.** Nga ajo se çfarë do të bëhej nëse nuk e realizoja dot?! Që do ta filloj me entuziazëm dhe nuk do të kem fuqi



dhe këmbëngulje të shkoj mëtej, që do të dorëzohem para kohe, që nuk do e bëj dot deri në fund. Nga kjo kisha frikë më shumë. Prandaj kisha nevojë të shkoja në aktivitete, të dëgjoja kasete, të lexoja libra dhe ta rrethoja veten me njerëz të cilët kanë efekte ndërtuese tek unë. U përpoqa të mënjanoj çdo efekt negativ.

**Njerëzit negativ i mbaja larg vetes, sepse e dija që nuk më çojnë përpara.**

E dija që nuk mund t'i lejoja vetes të kisha ndjenja të papjekura. Nuk u morra shumë me jo-të, nuk e analizova gjatë përse njerëzit nuk

duan të dalin nga situata e pashpresë, përse nuk duan ta ndryshojnë jetën e tyre, por u përpoqa të kërkoja njerëzit që duan të ndryshojnë dhe të cilët mund të ndihmohen. Dhe koha më dha të drejtë!

Kisha turp të flisja përpara njerëzve, por edhe kështu arrita ta bëj!

**Ky është një biznes njerëzor** dhe mua më entuziazmon. Më entuziazmon që bashkëpunonjësit e mi arrijnë rezultate dhe më motivon fakti që mund t'i ndihmoj ata. Më motivon entuziazmi, vrulli, këmbëngulja dhe forca e dëshirës së tyre. Më entuziazmon fakti që

për çdo gjeneratë ekziston një perspektivë, një diçka që mund të arrihet nga kushdo nëse arrin ta besoj që është në gjendje ta realizoj.

Kur shikoj skuadrën time të Miskolc-it, **Gabi Görgenyi-n**, skuadrën e madhe të **Andi Varga-s dhe Rita-s, çiftin Sagi, Zsolt dhe Rita Kószegi-n, Attila Földi-n** apo **vëllain tim**, më jep forca të mëdha dashamirësi, entuziazmi dhe dëshira e tyre e madhe. Është ndjenjë e mirë kur shikoj që edhe ata qëndrojnë në skenë dhe përjetojnë vlerësimet që kemi përjetuar edhe ne. Jam shumë krenare që njerëz të tillë janë anëtarë të skuadrës sime.

Jam shumë krenare për skuadrën e madhe me të cilët punojmë së bashku, me të cilët na ndërthuren interesat materiale, dhe dashuria e të cilëve për njerëzit dhe biznesin është shembull për mua dhe gjithë anëtarët e skuadrës sime. Falenderoj **Csilla Szekely-in** dhe skuadrën e saj, **Zsolt Roth-in, Marti Bognar-in** dhe gjithë skuadrën e Pecs-it, **Kata Ungar-in, Jani Sztana-n, Zsuzsa Lenkey-n** për miqësinë dhe dashamirësinë e tyre. Është mirë të jesh së bashku me ju!

... dhe falenderoj kryesisht **Tamas Biro-n** që është me ne!

Faleminderit për mundësinë dhe u uroj suksese të shumta të gjithë atyre që e marrën vendimin!





**PATRICIA HORVATH**  
managere

**FLP-ja provoi disa herë të trokasë në jetën time, por për fat të keq – tani është e lehtë të jesh i zgjuar – derisa problemet shëndetësore nuk më detyruan nuk ia hapa derën kësaj mundësie të mrekullueshme.**

## Dua të jetoj

Në vitin 1999 mbarova universitetin e inxhinierisë ushqimore, pastaj pothuajse menjëherë u bëra drejtore e një nga fabrikave të mëdha të Kompanisë së Pjekjes. Me vrullin e një të riu dhe me një dëshirë maksimale për të treguar vetveten i hyra punës sime si drejtuese, ku megjithëse mësova dhe përfitova shumë, prapë nga dita në ditë ngrihesha me ndjenjën që dëshiroj një diçka tjetër në jetë.

Në këtë kohë u njoha me **Zsoka Ernszt Antalne-n** e cila gjatë një ekskursioni ma thirri shpeshherë vëmendjen për efektet e shkëlqyera të aloe-s. Si rezultat i kësaj në fund të ekskursionit po mendoja seriozisht që ose ta hidhja nga autobusi nëse do ta nxirrte edhe njëherë nga goja emrin e kësaj bime.

Kaluan muajt dhe si rezultat i këmbënguljes së **Zsoka-s** shkova në një prezantim të hapur. Aty u njoha me **Zoltan Becz-in** i cili më sqaroi jo vetëm përsosmërinë e produkteve, por edhe mundësinë e biznesit. Ndërkohë pyeta veten: “Çfarë i duket vetja këtij? Jam drejtore me makinë,

me telefon, nuk pi as duhan, as kafe, kam bërë sport, çdo ditë ha gjellë të gatuar. . . Atëherë përse më duhen mua produktet apo tregëtia?”

Pastaj në shkurt të 2002-shit nga njëra ditë në tjetrën ma vështirësoi jetën një sëmundje. Filloi një luftë e vështirë dhe e gjatë prej afërsisht prej dy vitesh, si rezultat i të cilës në maj të 2004-ës u bëra mirë. Shërimi im ishte si një përrallë dhe tepër i ndërlikuar: terapi tradicionale mjekësore, mjekësi popullore, ndryshim i mënyrës së të menduarit, produktet e FLP-së, si dhe mbështetja e vazhdueshme e familjes dhe bashkëshortit tim **Attila**.

Ditët e nxehta të verës së 2004-ës i shfrytëzova për t’u fuqizuar dhe gjatë kësaj periudhe kisha kohë të mendohesha për të ardhmen. Isha e bindur se nuk doja të isha më nëpunëse, por për të nisur biznes nuk kishim burime të mjaftueshme. Në këtë kohë m’u kujtua ajo që më tha bashkëshorti im përpara tetë muajve. Kur isha shtrirë në krevat si e sëmurë më tha që do të ishte mirë të



shërohesha sepse duhet të ndërtojmë rrjetin tonë! Fati i tij i vetëm ishte që për shkak të trombozës ma kishin lidhur këmbën, kështu që nuk mund ta godisja dot me shkelëm. Kurse atë që i thashë në vend të kësaj më mirë nuk po e them, sepse prapë do ta cenzuronin...

Pra fitoi mendja e kthjellët, morrëm në telefon linjën tonë të sipërme, **Zoltan dhe Monika Becz-in** dhe iu lutëm të na ndihmonin në nisje. Dhe kështu në gusht të 2004-ës filluam punën. Shënimi i listës së emrave, përcaktimi i qëllimeve, lënia e takimeve, durimi i shprehjes skeptike të fytyrës së familjes, etj. Mendova se kisha një rreth të mirë njohurie, plot me intelektualë dhe studentë, të cilët me siguri e kuptojnë se çfarë biznesi fantastik është FLP-ja. Ha-ha! Për këtë nuk duhet të isha kaq i sigurt! Të gjithë më përqeshën dhe më përbuzën. Për fat të mirë këtë nuk duhet ta dëgjoja të gjithë vetëm, pasi në takime me mua erdhi edhe **Zoli** i cili më mbështeste. Dhe i shkreti ai, në shtëpi duhet të dëgjonte gjithmonë që ky biznes nuk është ai biznes që menduam. Kishte ditë kur duke qarë e hodha fletoren e qëllimeve në mes të kuzhinës, madje premtova se po të jetë edhe e nesërmja kaq e tmershme, atëherë do ta hedh edhe nga ballkoni. Por pastaj në tetor të 2004-ës arritëm nivelin e supervisorit. Dhe atëherë në skenë çështja morri kuptim të ri! "S'ka lojra! Niveli i managerit duhet arritur, sikur edhe me kokë poshtë!"

Dhe ndërkohë edhe prindërit e mi u bashkuan me ne. E panë se ndërtimi i rrjetit më jem kënaqësi, zhvillohem shumë si rrjedhim i aktiviteteve, mendoj në mënyrë pozitive dhe të



mos harrojmë as faktin që edhe produktet janë të shkëlqyera dhe është diçka e mirë që mund të ndihmoj të tjerët.

Pastaj ngecëm në këtë nivel deri në shkurt të 2005-ës. Në çdo muaj bënim rreth 20 pikë. Isha tepër e mërzitur kur **Zoli** më tha që në biznes ndodh një zhvillim i padukshëm. Kështu të paktën do të kem një skuadër të vogël stabile. Por vetëm që unë isha ngopur me këtë fjali dhe me zhvillimin e padukshëm! Prandaj nga inati dhe dëshpërimi e dërgova kurrikulumin tim në disa vende të ndryshme me qëllimin që të hyj përsëri në kampin e nëpunësve. Këtë gjë ia thashë edhe sponsorit tim, tek i cili me këtë aksion nuk shkaktova ndonjë gëzim të madh. Pas një kohe të shkurtër do më merrnin edhe në punë si drejtuese

e sigurimit të cilësisë, por pasi u mendova gjatë e refuzova. Në ndërgjegjeje i dhashë një mundësi të re FLP-së!

Pastaj ndodhi mrekullia! Disa muaj më parë u ulëm të bisedonim me një shoqen time të kursit (**Orsi Crsmely**), e cila atëherë filloi t'i përdorë produktet së bashku me burrin e saj. U mendua edhe atëherë për mundësinë e biznesit, por jo shumë seriozisht. Por prapë u kthye në shtëpi e mbushur plot me libra dhe CD. Pastaj njëherë më merr në telefon dhe më thotë fjalinë e ëmbël: "**Miklos Berkics-i** më tha që nëse dëshiroj të punoj, mos ta bëj vetëm! Unë tani dua të punoj, atëherë duhet të flas me ty, apo jo?" Mezi e nxorra "po-në". Kështu ndodhi ngjarja e madhe që falë punës së madhe të

**Orsi-t** — ndërkohë që unë natyrisht kërkoja mëtej njerëz të rinj — në mars pikët tona u rritën nga 20 në 30. Dhe ne shkronim mëtej. Në bllokun tim të vogël të shënimeve me ngjyrë të zezë ishin shkruar 4-5 biseda në ditë, nga të cilat edhe me anullimet e mundshme realizoheshin mesatarisht 3-5.

Prindërit e mi gjatë një vizite që na bënë e vunë re “rrjetin tonë të shkruar” që zbukuronte derën. Në rreth të kuq ndodheshin ata që punonin shumë, kurse në rreth jeshil ata që ecnin ngadalë. Prindërit e mi ishin në rreth jeshil. Kur iu shpjegova se përse ndodheshin në rreth jeshil, nuk u erdhi mirë, sepse donin të ishin në rreth të kuq. Pra u nis edhe grupi i Kanizsës.

U nis orteku! **Orsi** përparonte, dhe filluan të punojnë edhe prindërit e mi. Kurse ne ecnim gjithmonë e më mirë, kështu në prill të 2005-ës na u bënë 48 pikë dhe u bëmë assistant managerë. Dhe atëherë takuam gradën e pestë! Tani përpara qëllimit do të ishte mëkat ta lije punën pas dore!

Pastaj afër 10 majit nuk ishim akoma aq mirë me pikë. E dija që duhet të shtonim edhe 73 pikë për t’u bërë manager! Por s’e kisha të qartë mënyrën se si. Dhe për një moment më pushtoi një ndjenjë dhe një mendim: “S’ka gjë të pamundur. Kur isha në gjëndje të shërohesha nga kjo sëmundje, atëherë arritja e këtyre niveleve duhet të jetë lojë fëmijësh!” Kjo më dha forcë. Është pak ekzagjerim që ishte lojë fëmijësh, por më 31 maj 2005, të martën në magazinë hapëm shampanjën. U bëmë managerë, kurse **Orsi** dhe prindërit e mi supervisorë. Kishim me të vërtetë shkak për të festuar!

Është e pamundur ta përshkruash këtë ndjenjë! Jam njeri i lumtur. Jam e lumtur sepse gjatë sëmundjes sime mësova shumë gjëra, ndërkohë gjeta bashkëshortin tim, dhe prindërit më ndihmuan në mënyrë mbinjerëzore (i falenderoj ata). M’u zhdukën të gjitha simptomat e kësaj sëmundje. Dhe ndërkohë bëra miq të rinj. Sponsorja ime, **Zsoka**, të cilës ia di

për faleminderit që më njohu me produktet. **Moni dhe Zoli** nga të cilët mësova shumë! Skuadra ime e vogël pa të cilët nuk do të kisha sukses: **Orsi**, prindërit e mi, **Andre Kovacs, Erika Horvath, Monika Mathe, Eszter Meszaros, Aranka dhe Erika Miko, Marti Halasz, Erika, Feri, Napsugar, Edit**, dhe shumë të tjerë. Dhe si përfundim, por jo në radhë të fundit, bashkëshorti im **Ati** i cili duroi gjithë atë që duhet të duronte, dhe që s’ishte pak. I falenderoj të gjithë!

Me të vërtetë më duket sikur nisa një jetë të re, pasi pa asnjë simptomë, në siguri materiale, mes miqve dhe duke u zhvilluar vazhdimisht mund t’u përcjell njohuritë dhe përvojat e mia gjithë njerëzve që dëshirojnë të ndryshojnë jetën e tyre. Shpresoj që sa më shpejt të mund t’i ndihmoj ata të provojnë ndjenjën që po provoj unë tani. Dëshiroj ta jetoj jetën sipas motos: “Është diçka e mirë të ndihmohesh njerëzit, por është akoma më e mirë t’i mësosh ata të ndihmojnë vetveten!”



## FOREVER LITE ULTRA

### çokollatë

Forever Lite Ultra tani gjendet edhe në formën e çokollatës! Gjithë karakteristikat me vlerë të Forever Lite Ultra-s origjinale i përziejme me shijen e çokollatës, duke krijuar në këtë mënyrë një variant të shijshëm e të shkëlqyer të ushqimit të shëndetshëm, të cilin mund ta konsumojmë pa na varurë ndërgjegjja.

Edhe në programin Clean + Lean na jepet mundësia të zgjedhim ndërmjet Forever Lite Ultra me shije çokollate apo vanilje. Pra të pijmë për shëndetin, të kënaqemi me Forever Lite Ultra — çokollatë!





**KRISTOF KARCZAG DHE  
AGOTA FEHER**  
managerë

**Tre fjalë negative të cilat së bashku kanë forcë pozitive. Këtë forcë dëshirojmë ta japim Ty.**

## Asnjëherë s'është vonë!

Ty që tani je ulur diku me revistën në dorë dhe po mendon se ti s'do ta bëje dot këtë. E ke të qartë se kushdo mund ta arrijë nivelin e managerit, pasi nga muaji në muaj shikon në skenë të kualifikuarit e rinj, por prapë të duket se ti bën përjashtim.

Ti edhe po të përpiqesh nuk e bën dot, sepse kjo do fat, dhe fati është me të gjithë, përveç teje. . . Harroje këtë! Fati është i mirë, dhe nëse e dëshiron me të vërtetë, atëherë është i mirë edhe me Ty. . . E di se çfarë ke në mendje, sepse edhe unë këto kisha për një kohë të gjatë.

Kur në vitin 1998 (e shikon, po ta shikojmë ndryshe kjo ishte në mijëvjeçarin e kaluar) **Vili Halomhegyi dhe Attila Erdős** më ofruan FLP-n nuk iu hodhëm menjëherë në qafë. Ishim në një gjendje "të dëmtuar nga MLM-ja" dhe i pranonim me dyshim të madh "produktet magjike" dhe mundësitë e mëdha të biznesit që na ofronin nga dita në ditë. Përse pikërisht këtë, përse pikërisht tani, përse pikërisht unë. . . ?

**Vili-t dhe Attila-s** me thënë të drejtën i besuam, pasi e njihnim njëri-tjetrin prej vitesh, por prapë nuk na entuziazmoi edhe aq shumë kjo gjë.

Dhe produktet e dhëna për provë na ndihmuan "nga pak", prandaj ramë dakort.

U nisëm vetëm nga ana e produkteve – sot e dimë se nuk duhet të kishim vepruar kështu – por edhe kështu për një muaj e gjysëm u bëmë supervisorë. Por entuziazmi ynë dhe konsumatorët e shumtë nuk mjaftonin për të ecur më përpara.

Nuk e kuptonim se ku qëndronte problemi. Sponsorët tanë na e thanë që në radhë të parë nuk na duhen blerës, por bashkëpunonjës, dhe ne nuk e besuam. Me zgjuarsi dhe inteligjencë të madhe menduam se ne do ta ndërtojmë biznesin në baza të reja; psh. që nga blerësit e kënaqur do të krijohen punonjësit e gjallë, apo që sa më shumë aq më mirë, si

dhe spekulime të tjera të tilla me të cilat gënjenim veten.

Por tani e shikojmë se në të vërtetë e kalonim kohën me veprimtari “alibi”. Shkonim në aktivitete, por nuk përfitonim nga ato, lexonim librat dhe dëgjonim kasetat, por nuk mësonim prej tyre, konsultoheshim me sponsorët tanë, por nuk i besonim atyre. Ti mos bëj të njëjtat gabime sepse ne këto na kushtuan shumë kohë dhe para.

Thelbi i historisë është që në çdo nivel të arritur qëndruam nga tre vjet. Mund të themi se na pëlqente medalja, apo jemi tipa besnik dhe prandaj nuk bëmë ndryshime të shpejta, por e vërteta është se nuk kishim motivimin e duhur. Kishim një fletore qëllimesh, por ajo ishte plot me gjëra të vjetra të arritura. Nuk nxirrnim qëllime të reja dhe fletorja nuk ishte pjesë e përditshme e jetës sonë, kështu që nuk mund të na vinte për ndihmë.

Kur kishim ndonjë motivim plus, atëherë atë e bënim vetëm për vete (niveli 1, 2 pastaj 3 i Rally-t European), por kjo ishte akoma e pamjaftueshme për të arritur nivelin e managerit, sepse nuk përqëndroheshim dhe nuk i mbledhnim të gjitha elementet në një të plotë.

Pastaj në Kopenhagë morrëm një vendim, për të cilin aty dhe në shtëpi morrëm ndihmë të madhe nga linjat tona vëllazërore (**Istvan Toth dhe Marti Zsiga, Ildiko Csepi dhe**

**Gabor Kovacs, Arpad dhe Erzsike Gyapay, Marika Debródi, Zsuzsa Varga**, si dhe shumë të tjerë nga çdo pjesë e vendit).

I falenderojmë ata që pavarësisht se e njohim njëri-tjetrin prej kohësh, menduan për ne dhe na dhanë forca të reja. Dhe tani në Nizë ishte përsëri së bashku “skuadra e madhe”. Gëzuam dhe festuam së bashku. Ishte një ndjenjë e mrekullueshme të kualifikohesh në skenën e Nizës dhe na dukej sikur mund ta fitonim edhe vetëm çmimin Spirit Award. Por për fat të mirë kishim edhe shokë me vete, kështu që nuk u dhamë asnjë mundësi vendeve të tjera.

Ajo ndjenjë nuk mund të tregohet, ajo duhet përjetuar. Tani detyra jonë më e rëndësishme është që këtë t’ua përcjellim bashkëpunonjësve tanë që vitin e ardhshëm edhe ata të duan të jenë në Stockholm.

Por të kthehem më në fund drejt asaj që na dha shtytjen e vërtetë. Falenderojmë **Vili Halomhegyi-n** për besimin e vazhdueshëm që pati për vite të tëra, por gjithë kjo do të ishte e pamjaftueshme nëse vitin që kaloi **Attila Erdős-i** nuk do më llogariste se sa para kemi humbur gjatë viteve të kaluara. Rezultati ishte shokues.

Pra në janar-shkurt morrëm vendimin që tani do ta bëjmë. Dhe jo vetëm për vete, por edhe për skuadrën tonë. Pasi nëse ne nuk arrijmë diku, atëherë ata nuk kanë ku të na ndjekin.

Por duhej edhe diçka që më në fund të bëheshim managerë. Vite më parë e kishim pranuar që ne nuk mund të bëhemi shembull për asnjëri, dhe kjo pjesë nuk na motivonte.

Por tani që të ecnim mëtej, duhet ta rivlerësonim këtë gjë. Dhe menduam se me të vërtetë nuk mund të bëhemi shembull për ata që e bëjnë mirë, shpejt dhe me efektivitet.

Por mund të bëhemi shembull i “shumicës së qetë”, i atyre që ndërtojnë “ngadalë, por me siguri”, të cilët qëndrojnë në vend prej vitesh të tëra, tek të cilët bashkëpunonjësit humbën besimin dhe u larguan, të cilët me të vërtetë dëshirojnë diçka, të cilët mendojnë të heqin dorë sepse ata s’e bëjnë dot!

Nëse në rreshtat e fundit gjete mendimet e tua, atëherë ta dish se erdhi koha jote. Dikush që mendonte dhe ishte në të njëjtën gjendje si ty, pati sukses. Beso tek sponsori yt sepse të do të mirën, dhe beso në vetvete sepse edhe ti je në gjendje ta bësh. Mos harro: **ASNJËHERË S’ËSHTË VONË !!!**

Si përfundim na prano një mendim që morrëm nga një vjershë e periudhës së mesjetës:

**Mos harxho kohën. Më mirë të kënaqesh me verigen e dendur sesa të qahesh që s’ka apo që është e thartë...**





**ANNA POLDAN DHE  
LASZLO BOROS**  
managerë

**Tani edhe Unë i përkas  
kampit të njerëzve të  
suksesshëm! Por natyrisht  
kjo nuk ishte gjithmonë  
kështu.**

## Postieri troket deri në 120 pikë!

Në kursin e majit në Lakitelek m'u realizua një ëndërr tepër sekrete. **Mikos Berkics** stërgjyshi i biznesit tim më kërkoi të mbaj një leksion të pavarur. Për ditë të tëra ndodhesha në gjendje euforike ndërkohë që fillova të merresha me materialin e leksionit. **Miki** më tha vetëm që: trego me sinqeritet historinë tënde.

Nga u nisëm dhe si përfunduam në skuadrën e madhe të FLP-së? Kam lindur si fëmijë i gjashtë në një fshat pranë Isaszeg-ut. Ishim shumë të varfër. Vitet kaluan, u martova dhe më lindën tre djemë të mrekullueshëm. Pastaj pas 21 vitesh bashkëshorti im vendosi të ndahet, më la dhe më dha pavarësinë. Për këtë e falenderoj sepse kështu pata mundësi të njoh bashkëshortin tim të tanishëm, **Laszlo Boros**. U bëmë me 5 fëmijë dhe me 6 nipër e mbesa, me të cilët krenohemi.

Kur u njohëm me FLP-n burri im ishte shumë i sëmurë. Këtë mundësi na e solli në vitin 2002 **Marta Takacs Bankine**. Ajo kërkonte bashkëpunonjës për biznesin e saj të sapofilluar. E dëgjuam. I thashë që puna nuk më interesonte, pasi jam postier dhe shes në treg, por burri im është i sëmurë dhe nëse ky

Xheli Aloe është kaq i mirë, atëherë po e provojmë. Blemë një shishe megjithëse nuk kisha shumë besim. E piu xhelin, nga 1 decilitër në ditë, dhe pas tre ditësh gjendja iu përmirësua. Fillova të mendoja. Pagesa si postier është e vogël, pensioni i burrit tim është pak, në treg na vodhën mallrat, por ky produkt na duhet! Dhe duhet të bëjmë paratë për ta blerë atë.

I thashë **Marti-t** dhe më 13 maj 2002 u regjistruam. Në nivelin 2 pikësh, në kuptimin e plotë të fjalës, hëngrëm vetveten. Bleva 10 katalogë, i shpërndava në zonën ku banoja, u tregova se me çfarë merrem dhe u thashë se do të vij të nesërmen. Në mes të muajit të 3-të u bëmë Supervisorë. Për këtë na ndihmoi shumë **Eszter Nagy** me të cilën punuam së bashku dhe tek e cila pata shumë besim. E arritëm nivelin 8 %-sh, i bëmë paratë e produkteve, po tani si të vazhdojmë? Erdhi Rally European i 2003-shit. **Aranka Vagasi**, me të cilën krenohem shumë dhe e cila është shembulli dhe këshilltarja ime, më rekomandoi që: ndërmjet atyre që arrijnë nivelin e parë në kursin e Adylygeti-t më 9 nëntor do të hedhë në llotari një çantë FLP-je të sjellë nga Amerika. U

ula pranë **Marti-t** dhe i thashë se kjo çantë do të bëhej e imja. M'u plotësua ëndrra, në nëntor çanta u bë e imja, dhe me nivelin e parë të Rally-t iu afruam edhe nivelit të Assistant Managerit. Punuam shumë bashkë me skuadrën dhe pikët mblihdeshin. Më 29-30 maj Rally European në Szirak. Më mungonin vetëm 3 pikë e gjysëm. Unë nuk do të shkoj nesër në Szirak, sepse po të shkoj nuk do t'i plotësoj dot pikët. **Eszter-i** më tha se duhet të shkoj, pasi kisha punuar dhe me siguri do t'i plotësoja. Kur po shkoja për në Szirak në autobus më binte vazhdimisht telefoni dhe vinin porosinë, kurse **Eszter-i** bënte llogaritë në magazinë dhe në mesditë më telefonoi që plotësua 79,5 pikë. Me këtë gëzim dhe lumturi në zemër u takova me **Rex Maughan-in**, thjeshtësia, dashamirësia e madhe për ne, respekti për njerëzit dhe shembulli i të cilit ishte diçka e mahnitshme për mua. Këtë nuk e kisha provuar asnjëherë në jetën time. I dhashë postës 15 vjet nga jeta ime, por asnjëherë nuk u takova me drejtorin. Dhe tani paratë nuk na mjaftonin vetëm për të blerë produktet, por hymë edhe në një sallon makinash dhe blemë makinën e parë me 0 kilometër në jetën tonë.

Ëndërrova për nivelin e Managerit, por derisa vetëm ëndërroja kjo mbeti ëndërr. Ju luta bashkëshortit tim të më ndihmonte në punë dhe punuam së bashku në Postë, në mënyrë që ta përfundoja sa më shpejt dhe të shkoja "të mbidhja pikët". Në fund të shtatorit morra vendimin që duhet ta arrij nivelin e managerit në fund të tetorit. Burri më tha që të zbrisja me këmbë në tokë, por unë nuk e dëgjova, kisha besim tek vetvetja dhe skuadra ime. Përparuam mirë, supervisorët tanë: **Mariann Banane, Zsoka Daranyine, Böbe**

**Viszlayne, Edit dhe Csaba Rozsa** vendosën të ndërtojnë skuadrën e tyre të Forever-it dhe të ndryshojnë jetën tonë. Falenderojmë çdo anëtar të skuadrës sonë, sponsorin tonë **Marta Takacs Bankine-n dhe Laci Bankin, Eszter Nagy-in dhe Laci Hajdu-n** për ndihmën e dhënë me punën e tyre të singertë që më 30 tetor të bëheshim Managerë. Medaliet tona i morrëm në Forever Success Day-n e nëntorit ku na shoqëroi familja jonë. Pas kësaj organizuam një mbrëmje fantastike ku ftuam edhe shefin dhe bashkëpunonjësit e mi, dhe këtu deklarova se nga 1 janari 2006 do të punoj vetëm në FLP. Nuk më besuan

dhe më morrën seriozisht vetëm kur më 31 dhjetor iu dhamë lamtumirën dhe kapelen e postierit e ndërruam me kapele të kuqe, të cilën e mbajmë me krenari si anëtarë të skuadrës së **Vagasi-t**.

Gëzimi ynë nuk përfundoi me kaq, sepse arritëm edhe nivelin e tretë të Rally-t European. Do të fluturoj për herë të parë në jetën time, por gëzimi më i madh për ne është që në Nizë bashkë me ne do të jenë edhe **Edit dhe Csaba Rozsa**.

Falenderojmë Forever Living Products që jo vetëm e ëndërrojme jetën por edhe mund t'i përjetojmë ëndrrat tona.





**J**ini plotësisht të përgatitur gjatë prezantimit të biznesit tuaj. E rëndësishme është t'i informoni në formë zyrtare bashkëpunonjësit tuaj të ardhshëm gjatë prezantimit të kompanisë sonë, familjes së produkteve, si dhe të mundësive që fshihen në marketingun e rrjetit. Për punën tuaj Forever Living Products ju siguron lëndë profesionale ndihmëse.

# Mundësi biznesi

## Mundësia më e madhe e botës – broshurë



Hidni një vështrim në botën e Multi-Level Marketing! Me ndihmën e kësaj broshure bëhet i qartë sfondi i biznesit të Forever Living Products dhe mund të kuptoni se përse është e jashtëzakonshme mundësia që ju ofrojmë. Shikoni mundësitë e ndryshme të të ardhurave, nivelet e biznesit, si dhe sistemin nga i cili distributorët tanë kudo në botë janë të kënaqur dhe të lumtur. Ta keni me vete në çdo bisedë në mënyrë që t'iu ndihmojë për prezantimit e biznesit. Është një mjet efektiv për t'i shpjeguar kujt do thelbin e biznesit tuaj.

**e re**



**e re**

## Ju ndihmojmë të arrini qëllimin

Ky material gjendet në formë CD-je auto-vizuale dhe broshure, me të cilin mund të parapërgatisni takimet tuaj të biznesit, ose mund ta lini të punojë në vendin tuaj deri në takimin e ardhshëm.

## Plani marketing – DVD

Mund të shikohet dhe kuptohet qartë mënyra se si ndërtohet sistemi i ndarjes me përqindje i Forever Living Products, dhe mund t'ia prezantoni thjeshtë mundësitë e shumta të të ardhurave kandidatëve tuaj. Me ndihmën e këtij materiali me figura dhe tabela për të gjithë bëhen të qarta pikësynimet të cilat iu ndihmojmë t'i arrini. Shikoni gjithë mundësitë e të ardhurave të niveleve të biznesit, bëjuni të qartë bashkëpunonjësjve tuaj mënyrën e kualifikimit për në "programin e makinës" apo udhëtimet e ndryshme.



## **Nga Supervisorit deri tek Managerit**

— fletore pune

Nëse i ndiqni nga hapi në hap këto udhëzime atëherë si rezultat i punës suaj mund të ndërtohet një biznes madhështor me baza të forta.



## **Planifikim biznesi**

— fletore pune

Ju siguron për afat të gjatë mjetin me të cilin mund të planifikoni çdo fazë të punës, dhe ju jep rrugëzgjdhje për ndarjen efektive të punës dhe kohës.

**J**anë tepër të rëndësishme për punonjësit fillestar, por edhe ata që punojnë prej kohësh mund të marrin një ndihmë me vlerë nga mjetet që mund të përdoren jo vetëm kur ulemi në makinë apo gjatë hekurosjes, por në çdo problem që na del.

CD-t me titull **Turbo Start** sjellin një rritje të madhe në biznesin e punonjësve që i përdorin ato.

Sigurojini dhe binduni që edhe bashkëpunonjësit tuaj i përdorin CD-t dhe kasetat rreth **përcaktimit të qëllimeve, planifikimit, ftesës, prezantimeve, rekomandimit të produkteve, trajtimit të preteksteve dhe ofrimit të biznesit**, të cilat janë krijuar në bazë të leksioneve të bashkëpunonjësve tanë të suksesshëm në ndërtimin e rrejtit.

Librat e shumtë për zhvillimin e personalitetit, udhëzuesit dhe manualët teknike dhe praktike janë mjete të domosdoshme për punën efektive dhe zhvillimin.

## **Hapat e para**

— fletore pune

U ofron ndihmë të gjithë punonjësve për të hedhur bazat e suksesit të biznesit të tyre.

### S H T Y P I

**Botuese:** Kompania Forever Living Products, Hungari.

**Redaktoi:** FLP Magyarország Kft. 1067 Budapest, Szondi u. 34. Telefon: (36-1) 269-5373 Fax: (36-1) 312-8455

**Redaktori kryesor:** Dr. Milesz Sándor

**Redaktor:** Kismárton Valéria, Petróczy Zsuzsanna, Pósa Kálmán, Rókás Sándor

**Përgatitja për shtypje:** Tipofill 2002 kft.

**Grafika:** Teszár Richárd, Buzássy Gábor

**Shtypi:** Veszprémi Nyomda Zrt. **U përgatit** në 48 750 kopje

Për përbajtjen e artikujve shkruarit mbajnë përgjegjësi! Çdo e drejtë mbrohet!

**Përkthyes, redaktues:** shqip: Dr. Marsel Nallbani – kroat: Darinka Aničić, Anić Antić Žarko

– serb: Tóth-Kása Ottília, Molnár Balázs, Meseldžija Dragana – sloven: Novak Császár Jolanda, Eurotranslate Ljubljana





FOREVER  
**POMESTEEN**  
POWER

ANTIOXIDANT FORMULA  
LIQUID DIETARY SUPPLEMENT

16 Fl. Oz. (1 pint) (473 ml)



FOREVER 

# POMESTEEN POWER

Kemi dëgjuar shumë rreth efekteve të forta antioksidante të shegës dhe mangostanit. Këto dy fruta janë tepër të njohura prej vitesh — jo rastësisht! Përmbajtja e antioksidantëve të shegës është më e lartë edhe se e boronicës së zezë, e çajit jeshil apo e verës. Mangostani e quajnë “mbreti i frutave” për shkak të shijes tepër të mirë dhe efektet e tij tepër të mira. Mangostani përmban në përqëndrim tepër të lartë xanhone të cilat janë antioksidantë biologjikisht aktiv. Efekti i tyre i mirë në sistemin imunitar konkuron me atë të vitaminës C dhe E. Këto dy fruta së bashku janë në gjendje ta mbështesin sistemin tonë imunitar edhe më me efektivitet se deri tani.

Shumë studime e mbështesin rolin e këtyre frutave edhe në fushën e ruajtjes së shëndetit! Prandaj Forever Living krijoi **Forever Pomesteen Power**. Përzierja e shkëlqyer e frutave përmban në përqëndrim të lartë antioksidantë dhe vitamin C. Me përdorimin e rregullt të Forever Pomesteen Power mund ta mbrojmë shëndetin tonë me një nga plotësuesit ushqimor më të efektshëm të tregut!

Në rastin e frutave gjithmonë më të errëtat janë më të mirat për shkak të përmbajtjes më të lartë të antioksidantëve. Rëndësia e antioksidantëve shpjegohet nga shumë studime. Sipas Dr. Pat Kendall, specialistit të ushqimie dhe ushqimit të Universitetit të Colorados antioksidantët janë të domosdoshëm sepse janë të aftë të asgjesojnë oksidantët reaktiv në organizëm. Sistemi ynë mbrojtës përpiqet t’i eliminojë këta oksidantë,

por për shkak të stresit dhe dëmtuesve të mjedisit shpeshherë lind nevoja që t’u ofrojmë mbrojtje të mëtejshme qelizave tona kundër efekteve dëmtuese.

Forever Living është e njohur për prodhimin e produkteve me cilësinë më të shkëlqyer, të cilat përgatiten në bazë të rezultateve kërkimore më të reja. Prandaj **Forever Pomesteen Power** përmban frutat që në bazë të rezultateve të këtyre studimeve tregojnë aktivitetin më të lartë antioksidant. Në krye të klasifikimit ndodhet mangostani dhe shega, pastaj vjen dardha, mjedra, manaferra, boronica dhe fara e rrushit, prandaj Forever Pomesteen Power është pija me përmbajtjen më të lartë të antioksidantëve. Madje edhe shijen e ka të mrekullueshme! Dhe po ta përziejmë me Xhelin Aloe Vera Forever efekti i dyfishohet!

Forever Pomesteen Power i përshtatet stilit të jetës dhe kërkesave të ushqimit të shëndetshëm të ditëve tona. 3 cl Forever Pomesteen Power të përzierë me 5 cl Xhel Aloe Vera në ditë është mjeti më i mirë për mbrojtjen e organizmit përballë sfidave të orareve të ngushta dhe dëmtuesve të pamënjatueshëm të mjedisit.

Pra vendosni me mend dhe bëheni pjesë të ushqimit tuaj të përditshëm Forever Pomesteen Power-in dhe Xhelin Aloe Vera!

Sistemi imunitar dhe organizmi juaj do t’ua di për faleminderit!



FOREVER LIVING PRODUCTS



*Sonyia*<sup>®</sup>  
Color Collection